

Dalës-Izlasna

Rr. 70-657

Data 13.09.2022

Br. Datum

48602-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

RAPORT

(Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025)

Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim me datë 26.08.2022 ka mbajtur diskutimin publik “Planifikimi i buxhtit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025”, diskutimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal nga ora 14:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent Ibush Mjekiqi nënkryetari i komunës, Zarife Behluli – drejtoresh e DEFZH-së dhe pjesëtarë të tjerë të ekzekutivit komunal.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 33 qytetarë, prej tyre 13 gra dhe 20 burra.

Pas prezantimit të Planifikimit të buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025, nënkryetari i komunës Ibush Mjekiqi shpali buxhetin në vija të trasha në 5 (pesë) kategori ku do të planifikohet saktë se cilat projekte do të realizohen për vitin 2023.

Buxheti i Komunës së Obiliqit për vitin 2023 për është planifikuar të jetë 12,921,229.00€ euro i ndarë në 5 (pesë) kategori ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 4,500,000.00€
- Mallra dhe shërbimet – 1,550,000.00€
- Shpenzimet Komunale – 380,000.00€
- Subvencionet dhe transferet – 1,000,000.00€
- Shpenzimet kapitale – 5,491,229.00€

Pas prezantimit të Planifimit të buxhetit për vitin 2023 dhe planifikimit për vitet 2023 dhe 2024, kemi pranuar një kërkesë nga qytetarët:

- Burim Gërguri, si prioritet mendoj se është salla e edukatës fizike, dhe nga debatete me qytetarët fokus kryesor ka pasur projekti i koogjenerimit.
- Nënkyetari Ibush Mjekiqi, këtë vit jemi në realizimin e shumë projekteve por siç e dini vështirësitë janë të mëdha sidomos me kontrata që janë të lidhura vitet e mëparshme, me shtrenjtime të produkteve të ndryshme. Kemi bërë shkëputjen e 8-9 kontratave dhe pastaj fillon procesi i lidhjes së kontratave të reja dhe merr kohë kjo gjë e cila do të na shkaktojë probleme, por ne nuk do të ndalemi deri në realizimin e këtyre projekteve. Përveç investimeve kapitale, komuna ka qenë përfituese edhe e grantit të performancës në vlerë prej : 808,000.00€ mjete këto të cilat do të shfrytëzohen për investime kapitale.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:20.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
12.09.2022



Zyrtar përgjegjës për konsultime publike
Festina Preniqi dhe Flaka Hashani